

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të pandehurit, F. S., për shkak të veprës penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr.1356/2014, të datës 18.08.2004, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 15.11.2016, shpalli publikisht dhe hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F. S., nga babai M. dhe nëna E., e lindur S., i lindur më datën ... në Gjilan, me vendbanim në fsh. G., Komuna e Gj., ka të kryer shkollën ..., ... martuar, ..., baba i ... fëmijëve, i gjendjes së varfër, shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, aktualisht është duke u udhëhequr procedurë tjetër penale ndaj tij,

ë s h t ë f a j t o r

Në muajin mars të vitit 2014, në kafiterinë “...” përballë furrës ... në Gj., i pandehuri F. S., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka blerë nga i pandehuri I. M., një televizor plazma të markës Samsung i vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit S. L. nga Gj. për cmimin prej 360 €, edhe pse në bazë të cmimit dhe rrethanava të blerjes, i pandehuri ka mund të dijë se sendet që po i blenë janë të përfituara me vepër penale të vjedhjes, dhe më vonë pasi që është zbuluar nga Njësia e hetimeve të Policisë, televizori konfiskohet dhe i dorëzohet pronarit, në këtë mënyrë të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar,

Me çka ka kryer veprën penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, e lidhur me nenin 365 të KPRK-së, të pandehurit, i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit, F. S., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri, brenda afatit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale,në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri detyrohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 30€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari S. V., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit F. M., për shkak të veprës penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi si dhe i pandehuri Fadil Hyseni, i cili është shoqëruar nga policia siaps urdhër-arrestit të gjykatës.

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri F. S., e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tijë në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimitare ka deklaruar: pasi që i pandehuri në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajsinë për veprën penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së, dhe se i njejtë , është njoftuar paraprakisht nga gjyqtari i vetëm gjykues, me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë, kështu që pas këtij njoftimi i pandehuri vullnetarisht dhe pa presion e shtytje

e ka pranuar fajsinë për veprën penale me të cilën ngarkohet. Prandaj i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptoi një sanksion penal meritor, me bindje se dënimi i shqiptuar, do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri.

Në fund kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit për të pandehurin e sipërtheksuar, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata të merr parasysh, pranimin e fajsisë për veprën e kryer, pendimin për të njejtën, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, si dhe faktin se është hera e parë që i njejtë ndeshet me ligjin. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë shkallën e përgjegjësive penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer nga i pandehuri.

I pandehuri F. H., në fjalën e vet përfundimtare, deklaroi: si në fillim të seancës, edhe në fjalën përfundimtare e pranoi fajsinë për veprën me të cilën ngarkohem, pendohem për të njejtën, kjo ka qenë hera e parë që kam rënë nëdesh me ligjin, kështu që i premtoj gjykatës se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, meqenëse jam i pa punësuar, kërkoj nga gjykata që brenda mundësive të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajsinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri F. S., në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitivin III. të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-së -së, për të cilën është edhe penalisht përgjegjës.

Andaj, gjykata të pandehurin e lartëcekur e shpalli fajtorë dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehuren, gjykata pati parasysh faktin se i njejtë e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, është penduar për të njejtën, se është hera e parë që ka rënë nëdesh me ligji, sjelljen korrekte të tij, si dhe faktin se i njejtë është i pa punësuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

I dëmtuari S.V., konform nenit 463 të KPPRK-së,për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat si më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i pergjithshëm.
P.nr.271/16, më 15.11.2016**

**Sekretarja juridike,
Rafete Sylja,d.v.**

**Gjyqtari
Islam Thaçi,d.v.**

Këshilla Juridike: *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.*